



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.62/2019  
Prishtinë, më 2.4.2019, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Lutfi Zharku, Liburn Aliu, Glauk Konjufca, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

**Pjesëmarrëse e ftuar:** Magbule Shkodra, zëvendësministre e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

**Pjesëmarrës:** Veneranda Nderca, MZHR; Shefki Kastrati, NDI; Agnesa Haxhiu dhe Majlinda Misini, KDI dhe Arta Berisha, GP- LVV.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Afrim Berisha, praktikant.

**Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1.Miratimi i rendit të ditës;**
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.3.2019;**
- 3.Diskutim lidhur me ndarjen e granteve nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, me theks të veçantë për bizneset e udhëhequra nga gratë;**
- 4.Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.3.2019**

*Procesverbali, i mbledhjes së datës 20.3.2019, u miratuan pa vërejte.*

## **3. Diskutim lidhur me ndarjen e granteve nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, me theks të veçantë për bizneset e udhëhequra nga gratë**

**Kryetarja** tha se komisioni e ka në planin e punës se vet edhe mbikëqyrjen e punës së ministrive dhe zbatimit të strategjive, përveç ligjeve që nxjerr Kuvendi, po ashtu ka në plan të vetin edhe t'i vizitojë bizneset dhe shumë shpejt do të dalim në terren për të vizituar bizneset, e që do të fillojë me dëshirë nga bizneset që udhëhiqen nga gratë. Ajo theksoi se ne jemi përcaktuar si shoqëri dhe politikë dhe në përgjithësi si Kosovë për t'i kushtuar vëmendje me theks të veçantë fuqizimit të gruas në çdo sferë, dhe për këtë arsye sot kemi ftuar zëvendësministren që të raportojë në lidhje me garantët që ndahen për të gjithë qytetarët e Kosovës, por ne jemi të interesuar të dimë se sa kanë aplikuar gratë në këto grante, sa kanë përfituar grante dhe sa ka pasur mundësi ministria që të përcjellë punën e kompanive, pasi që kanë përfituar këto grante. Në lidhje me politikat dhe objektivat e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ne kemi pasur edhe ministrin, z. Rasim Demiri, që të raportojë për punën e kësaj ministrie, mirëpo qëllimi i takimit të sotëm është sepse në agjendën tuaj edhe si zëvendësministre edhe si grua e keni për obligim fuqizimin e gruas, me qenë se ka përfunduar java e gruas, në javën që lamë pas, ku ka qenë një mobilizim i tërësishëm, këtu në këtë sallë kemi edhe të rinjtë dhe të reja që kanë qenë pjesë e javës së gruas dhe pasi që çdo ditë flitet për gruan dhe festohet një festë e gruas njëherë në vit, ne, si shoqëri dhe si Kosovë, jemi të obliguar që jo vetëm një ditë apo një javë t'ia kushtojmë çështjes së gruas, por angazhimi dhe përkushtimi jonë duhet të jetë i përditshëm në çdo segment dhe në çdo sferë të jetës sepse kjo ndikim pozitiv ne shoqëri.

**Magbule Shkodra, zëvendësministre e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**, tha se Ministria e Zhvillimit Rajonal ka në objektivat e veta përkrahjen e rajoneve ekonomike të Kosovës, përkrahja bëhet në dy komponentë: komponenti ku u behet asistence komunave për projektet që ato aplikojnë, pra për investimet kapitale dhe projektet që janë ne interes të komunitetit apo publikut dhe komponenti e dytë është ajo që ne u ofrojmë sektorit privat apo bizneseve. Vitin e kaluar ne kishim një buxhet të vogël me rreth 1 (një) milion e gjysme euro, dhe kishim 1700 aplikues për grante, ku prej tyre 27 % e përfituesve ishin gratë dhe vajzat, nëse gjatë vlerësimit kanë pikë të barabarta një burrë dhe një grua, atëherë ne u japim përparësi grave, është një diskriminim pozitiv që të mund të kontribuojmë që ato të kenë mundësi të fillojnë biznese apo të zhvillojnë bizneset me tutje. Në sektorin e prodhimit kemi vërejtur se nuk kemi pasur një numër të madh të aplikuesve gra, pasi që edhe të dhënat statistikore flasin së vetëm 17% të bizneseve të prodhimit janë pronare gratë. Këtë vit kemi avancuar sepse kemi bërë një platforme online sepse kemi menduar t'ua lehtësojmë aplikimin grave dhe ministria jonë është përkujdes që t'i asistojnë aplikuesit në 5 rajone nga Agjencia zhvillimore rajonale. Ne mbajmë edhe sesione informuese, sepse ka gra që duan të aplikojnë, por nuk kanë ndonjë ide, apo nga

ato që kanë ide, por që nuk dinë të aplikojnë dhe ne i kemi asistuar ato. Ka ndonjëherë edhe raste kur në emër të grave aplikojnë burrat, pikërisht për shkak të këtij diskriminimit pozitiv që e bëjmë, këto janë disa probleme që me kohën do të eliminohen dhe do të arrihen rezultate të kënaqshme, por ne inkurajojmë gratë që të aplikojnë dhe në të ardhmen të ia dalin të fillojnë bizneset e veta.

**Muharrem Nitaj** pyeti - ju thatë që 17% e bartësve të bizneseve nga fusha e prodhimit janë gra, dhe ndihma nga ministria ka qenë 27%, nëse gratë në biznes dhe përqindja mbërrin nga 17% në 27%, a mos është diskriminim për burrat në favor të grave dhe a mund të paraqet shqetësim real?

**Magbule Shkodra, zëvendësministre e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**, tha se të dhënat e paraqitura janë të vërteta dhe dua të cek që këto grante kanë qenë të ndara në 3 Lote, Loti 1 start up biznes, loti 2 për biznese që janë themeluar që 2 vite dhe loti 3 për biznese që janë themeluar me shumë se 2 vjet. Start up bizneset i kemi përkrahur thuajse të gjitha, dhe ndoshta kjo ka ndikuar që përqindja të rritet në 27%, por ne jemi kujdesur që mos t'i diskriminojmë burrat. Gratë të cilat nuk kanë arritur të përfitojnë nga grantet e ministrisë ne jemi kujdesur që të gjejmë donatorë tjerë, të cilët tani janë duke i shqyrtuar aplikacionet e tyre.

**Liburn Aliu** pyeti, a ka transparencë dhe këto informacione a mund të merren në web- faqe të ministrisë, për procedurat e aplikimit apo për të shikuar ata që kanë përfituar grante?

**Magbule Shkodra, zëvendësministre e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**, tha se ne jemi të kujdesshëm që të jemi transparent, dhe gjithëherë i publikojmë thirrjet për grante, pas selektimit, ata që nuk janë përfitues u dërgohet një informacion që ata të dinë pse ata nuk janë përfitues dhe ideja ka qenë që ata të informohen saktë dhe të mos bëjnë gabimet e njëjta ne aplikimet e radhës dhe pastaj behën publike edhe informatat për ata që janë përfitues të granteve.

**Veton Berisha** u interesua te dijë se sa ka pasur ndarje të granteve për komunitetet, sepse është një kategori që duhet t'u japim prioritet, dhe këto kategori duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë. Ai tha që nuk bëni asgjë të keqe nëse bëni një diskriminim pozitiv për të përkrahur këto kategori, kemi pasur edhe raste në të kaluarën kur gratë janë përdorur vetëm sa për të aplikuar, ndërsa punët janë kryer nga burrat, kështu që ne jemi të interesuar që ato të jenë të qëndrueshme, por pres që këto kategori të përkrahen sepse janë kategori të lëna anash.

**Magbule Shkodra, zëvendësministre e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**, tha se nuk bëjmë diskriminim, pavarësisht se nga cili komunitet vijnë aplikantët, diskriminimin pozitiv e bëjmë vetëm në aplikacionet që janë të poentuara njëjtë, pa marrë parasysh a është grua shqiptare apo e komuniteteve tjera, ato përkrahen dhe ne nuk duam të bëjmë ndasi të tilla. Ne të kaluarën ka gra përfituese të komuniteteve të ndryshme. Bizneset janë monitoruar për se afërmi dhe janë krijuar vende të konsiderueshme të punës dhe ne kemi një listë të bizneseve që ju mund t'i vizitoni dhe të shkoni të shikoni për se afërmi se si janë duke shkuar punët në këto biznese.

**Glauk Konjufca** u shpreh skeptik për krijimin e kësaj ministrie që nga fillimi i qeverisë dhe koalicionit qeverisës, po ashtu nuk shpreh bindjen për punën që kanë bërë si ministri, si dhe konsideron si ministri të panevojshme. Ai tha se papunësia në Kosovë sillet nga 30-40% sipas

statistikave që kemi, por mesatarja është rreth 36%, por kur dalim të komuniteti RAE niveli apo përqindja rritet dhe kështu ndodh edhe te gratë, pra sipas statistikave vetëm 13% e grave janë aktive në tregun e punës në Kosovë, kështu që çështja e ngritur nga kolegu parafolës ishte plotësisht e drejtë. Andaj masat që duhet të merren nga ministria është që përqindja e grave në tregun e punës të rritet. A ka strategji ministria që të rrisë këtë përqindje dhe jo vetëm të mirëmbajë këtë përqindje?

**Kryetarja** potencoi që nuk beson që nuk ka lëvize përqindja e numrit të grave të angazhuara në tregun e punës, por është mirë që deputetët të mos mbyllin në zyrat e punës, por të dalin në terren dhe të prekin segmentet e zhvillimit ekonomik të vendit. Ajo theksoi se ministri, z. Rasim Demiri, kur ka raportuar në këtë komision para disa kohësh, ka thënë që mbi 600 vende të punës janë hapur nga grantët e ofruara nga ministria, dhe nuk e di se si këto shifra nuk kanë ndërruar dhe nuk janë përfshirë në shifrat e papunësisë. Ajo tha se e ka përshtypjen se nuk i konsiderojnë si vende pune këto grante, pra vende pune konsiderojnë vetëm vendet e punës në institucionet publike. Pyeti se a ka mekanizma koordinues mes ministrive që të njëjtat aplikacione mos të dërgohen në dy apo me shumë ministrive që me të njëjtin projekt mos të mund të përfitohet në më shumë se një ministri, pasi që janë 8 ministri që merren me zhvillim ekonomik, ministria e juaj a ka bërë ndonjë klasifikim se ne cilat fusha janë ndare më shumë grante, apo kanë qenë të përgjithshme?

**Magbule Shkodra, zëvendësministre e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal**, fushat të cilat ministria e zhvillimit rajonal mbështet janë fusha e prodhimit dhe nuk ka mundësi që një aplikacion të përfitojë më shumë se në një ministri. Sa i përket asaj se a ka pasur nevojë për ministrinë tonë, nuk kam dëshirë të lëshohem në këto gjëra, por obligimi jonë është që të thithim fonde nga Bashkimi Evropian dhe këto fonde i marrim përmes këtij institucioni dhe si ministri me kalimin e kohës do e vëreni që ne kemi pasur shumë nevojë për një ministri të tillë.

**Liburn Aliu** tha që Ministria e Zhvillimit Rajonal ka mundur të jetë një departament në një ministri tjetër, është vërtetë që kemi nevojë për zhvillim ekonomik dhe fonde nga Bashkimi Evropian, por prapë nuk mendoj që kemi pasur nevojë për këtë ministri.

**Glauk Konjufca** potencoi që ato çka u thanë nuk paraqesin argumente, sepse kjo i bie që Kosova nuk ka përfituar fonde në të kaluarën kur nuk e ka pasur këtë ministri. Kjo ministri ka qenë pjesë e një departamenti të veçantë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Pasi që ka 1 vit e gjysmë që ekziston kjo ministri është dashur të ketë strategji për rajonet industriale p. Sh.: në Gjakovë dhe Mitrovicë, sepse këto janë në pikë të ulët të zhvillimit ekonomik dhe për këto vende duhet të behën strategji për t'u përballur me rënien industriale të këtyre dy rajoneve dhe jo të koncentrohemi se a mund t'i marrim fondet e BE-së.

*Pas diskutimeve, komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*Ministria e Zhvillimit Rajonal të dorëzojë në Komision listën e bizneseve dhe listën e përfituesve të granteve, me theks të veçantë përfituese gratë.*

#### **4. Të ndryshme** **Çështjet vijuese**

##### **a) Takimi me përfaqësuesit e Bankës Botërore**

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët komisionit që përfaqësuesit e Bankës Botërore, kanë kërkuar takimi me komisionin, ku do të prezantojnë Raportin periodik për Ballkanin, pjesën e Kosovës, për nesër më 3.4.2019 në orën 13:00.

*Komisioni u pajtua që ta pret këtë delegacion nga Banka Botërore.*

##### **b) Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Shërbime**

**Kryetarja**, i njoftoi anëtarët e komisionit për punën e grupit punues që është duke e monitoruar zbatimin e Ligjit për shërbime, ku tha që grupi punues i ka zhvilluar disa takime dhe ka filluar më vizita në terren në bazë të plani veprimit të ndihmuar dhe nga OJQ DPLUS na është propozuara që ta zhvillojmë një vizitë punë në Kroaci, për t'i parë praktikën se si e kanë të rregulluar ligjin për shërbime. Kërkoj nëse dikush nga anëtarët e komisionit, nëse dëshiron, ti bashkëngjitet grupit të punës në këtë vizitë është i mirëseardhur, edhe pse për t'u përfshirë në grup punë ka pasur hezitim nga deputetët.

*Anëtarët e komisionit që dëshirojnë t'i bashkëngjiten grupit punues në vizitën jashtë shtetit të njoftojnë me kohë grupin e punës.*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:15.**

**E përgatiti: Staf mbështetës i komisionit**

**Kryetarja e komisionit,**

**Sala BERISHA SHALA**